



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVAT
ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "AA BAILIFF" SH.P.K.

Nr.5825 Prot.
Dosje Nr. 1898

Tiranë, më 12/07/2022

URDHËR

"Për vendosjen e sekuestros mbi kuotat e debitorit"



Drejtuar: QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

Për dijeni: EVRO ASHENSOR SHPK me NIPT K92303024B

Adresë: Autostrada Tiranë Durrës, Km 6, Ndërtesë 2 Katëshe Pranë QTU Kati 1, Durrës.

Unë **Oltion Naumi** përmbarues gjyqësor privat pranë zyrës përmbarimit privat AA Bailiff sh.p.k., pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore Nr. 1898 bazuar në Urdhërin e Ekzekutimit Nr. 4480 Vendimi, datë 20/06/2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

KONSTATOVA:

Se më datë 20/05/2022 është lidhur kontrata e shërbimit midis zyrës përmbarimit privat AA Bailiff sh.p.k dhe kreditorit Tranzit Shpk, me objekt ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv – Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 4480 Vendimi, datë 20/06/2019, me palë dhe objekt:

- Kreditor: Tranzit shpk (Kontrate datë 21/10/2016)
- Debitorë: EVRO ASHENSOR SHPK me NIPT K92303024B
- Objekti: Pagesë detyrimi

Për ekzekutimin e Urdhërit të Ekzekutimit, duhet të kryhet vënia e sekuestros mbi çdo pasuri të debitorit me qëllim shlyerjen e detyrimit ndaj kreditorit Tranzit sh.p.k.
Për sa më sipër, si dhe në zbatim të neneve 519, 527, 560, 563 e në vijim të K.Pr.Civile si dhe të Ligjit Nr.26, datë 08/05/2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat"

URDHËROJ:

1. Vendosjen e sekuestros mbi subjektin;

- EVRO ASHENSOR SHPK me NIPT K92303024B, me seli: Autostrada Tiranë Durrës, Km 6, Ndërtesë 2 Katëshe Pranë QTU Kati 1 Tiranë;

duke ndaluar disponimin ose tjetërsimin e tyre, si dhe ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga këto kuota.

2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë, do të aplikohet sanksioni i gjobës në zbatim të nenit 606 të K.Pr.Civile si dhe kallëzimi për ndjekje penale në zbatim të nenit 320 të K.Penal.
4. Ky urdhër u njoftohet palëve të interesuara, të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve.

ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "AA BAILIFF" SHPK
PËRMBARUESI GJYQËSOR
OLTION NAUMI



AA BAILIFF

Rr. "Kavajes", Ndërtesa 27, Hyrja 1, Kati 4, Tiranë. Cel.: +355 68 8012846 . aabailiff@gmail.com

